

**Seminar Trajnimi për menaxherët e kërkimit dhe
Brokerage Event në kuadër të programit FP7 të BE për TRANSPORTIN**

**(në kontekst të Konferencës së IV Evropiane në ICT për Logjistikën në Transport
/ECITL'11)**

Ky workshop 1 ditor është hartuar për të rritur njohuritë e menaxherëve të kërkimit në vendet e Ballkanit Perëndimor në kuadër të përgatitjes dhe pjesëmarrjes në FP 7. Fokusi i trajnimit janë menaxherët e kërkimit dhe kërkuesit nga rajoni dhe është i përqendruar në ICT dhe Transport /Logjistikë. Trajnimi interaktiv do të përfshijë çështje të tilla si përgatitja e një propozim kërkimi, ndërtimi i një konsorciumi, menaxhimi i projektit të kërkimit (përfshirë ciklin e plotë të menaxhimit), dhe oportunitetet e financimit. Ai adreson kërkuesit si dhe anëtarët e komunitetit të akademikeve dhe biznesit, veçanërisht nga vendet e Ballkanit Perëndimor – por jo vetëm. Ai synon të ofrojë udhëzimet e nevojshme dhe informacionin përmes sesioneve trajnuese të thelluara të kombinuara me shembuj.

Seminari nuk ka tarifë pjesëmarrje, por kërkon regjistrimin paraprak. Axhenda si dhe Forma e Regjistrimit janë të disponueshme për të gjithë palët e interesuara në site e projektit: <http://www.wbc-inco.net/object/calendar/117309.html>

Organizimi përkrah njëri tjetrit i Seminarit të Trajnimit dhe Eventit të Ndërmjetësimit me qëllim që të nxisin pjesëmarrjen e kërkuesve nga vendet e Ballkanit Perëndimor në projektet Evropiane. Kështu të dy eventet të fokusuara në Thirrjen e re të FP 7 për Transportin, do të kombinojnë aktivitetet e tyre (përgatitje e duhur e propozimit – tërheqja e partnerëve për të ngritur konsorciume) me synimin për të dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të ndihmojë për pjesëmarrjen e suksesshme në Thirrje specifike. Me qëllim të arritjes së këtij objekti kërkohet pjesëmarrje sa më e gjerë të jetë e mundur nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Lidhur me këtë, ju lutem vëmendjen tuaj me qëllim të tërheqjes të sa më shumë pjesëmarrësve nga Ballkani Perëndimor në fushën e Transportit **tarifa e reduktuar prej 150 Euro** (në vend të 350 tarifë e plotë) është propozuar për pjesëmarrësit nga këto vende në eventin e WBC-INCO.NET, në mënyrë që ata të ndjekin me dëshirën e tyre gjithashtu Konferencën **ECITL 2011 në 13-14 Tetor 2011 (Porti i Selanikut,** më shumë informacion në <http://www.ecitl.eu/index.php>)

Si gjithmonë informacion më të detajuar mund të gjeni në web-site e projektit (<http://www.wbc-inco.net/object/calendar/117309.html>) që do të pasurohet së shpejti me më shumë materiale dhe info për udhëtimin dhe akomodimin.